

KUVENDI E MIRATON NË PARIM PROJEKTLIGJIN PËR QENDRËN HISTORIKE TË PRIZRENIT

Kuvendi shpërfill vullnetin e prizrenasve në emër të Ahtisaarit

Me insistimin e kryeministrit, Hashim Thaçi, shumica e deputetëve të koalicionit qeverisës i kanë injoruar 10 mijë qytetarë të Prizrenit, dhjetëra përfaqësues të shoqërisë civile, shumicën e asamblistëve komunalë, kolegët e tyre në Komisionin funksional parlamentar, si dhe anëtarët e Këshillit për trashëgimi kulturore, dhe kanë votuar pro miratimit në parim të Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit

vijon nga ballina

Thaçi: Kundërshtarët shesin patriotizëm fals

Por, as ndalesat e as ndikimet politike që mund t'i ketë ky projektligj nuk e kanë penguar kryeministrin Hashim Thaçi që të kërkojë nga deputetët e të gjitha grupeve parlamentare që ta mbështesin miratimin e tij, si shenjë vullneti për ta zbatuar në përpikëri Planin e Ahtisaarit.

Të gjithë atyre që janë shprehur kundër projektligjit, ai u ka thënë se nuk kanë nevojë të paraqiten patriotë, sepse do të dalin “patriotë fals”, për faktin se të gjithë janë të vetëdijshëm se mbi Planin e Ahtisaarit është ndër-tuar edhe shteti i Kosovës. Ai ka rikujtuar se të gjitha partitë parlamentare e kanë mbështetur këtë plan, përfshirë edhe “Vetëvendosjen”, e cila sa e sa herë ka organizuar protesta kundër Pakos së Ahtisaarit. Edhe pse ky konstatim i tij ka nxitur reagimin e deputetëve të VV-së, Thaçi e ka argumentuar atë duke thënë se VV-ja e ka pranuar Planin e Ahtisaarit në momentin që ka pranuar të hyjë në zgjedhje për t'u bërë pjesë e institucioneve të larta shtetërore. Thaçi ka mohuar që miratimi i një projektligji të tillë po bëhet me presion nga jashtë.

“Ky projektligj është obligim kushtetues dhe ligjor dhe jo presion ndërkombëtar. Gjithë ajo që kërkoj është që të votoji për ose kundër, por së paku mos thirrni për urrejtje ndërqytetare dhe mos mbillni frikë. Nuk rrezikohet Kosova duke respektuar të drejtat e komuniteteve. Nuk rrezikohet Kosova nga objektet e kultit. Mos shitni patriotizëm fals. Deficitet e së kaluarës nuk mund t'ua mbulojmë sot. Nuk është koha e fushatës elektorale”, është shprehur Thaçi.

Thaçi: Mediet pa TVSH

Kryeministri Hashim Thaçi është zotuar se do ta përmbushë premtimin elektoral për heqjen e tatimit mbi vlerën e shtuar për media qysh në mbledhjen e parë të radhës së Qeverisë, e cila pritet të mbahet të mërkurën. Ai i ka njoftuar ligjvënësit se aktualisht janë duke i bërë konsultat e fundit me partnerët e jashtëm të Qeverisë, në mënyrë që çështja e TVSH-së për media të jetë në harmoni me standartet ndërkombëtare.

“Kam shpresë se kjo çështje të përmbyllet shumë shpejt dhe medie-ve do t'u krijohet hapësirë më e madhe për punë”, ka thënë Thaçi. Këto shpjegime ai i ka dhënë duke iu përgjigjur deputetes së “Vetëvendosjes”, Alma Lama, e cila ka shprehur interesimin të dijë pse Qeveria vazhdon t'i tatimorë mediet në kundërshtim me premtimin që kishte bërë ai gjatë fushatës së fundit zgjedhore. Lama, e cila për një kohë ka qenë gazetare, ka rikujtuar se shumica e vendeve të BE-së nuk kanë fare TVSH për media. Si shembull ka marrë Britaninë e Madhe, ku mediet konsiderohet të jenë shumë të fuqishme. Lama ka thënë se edhe në rajon ka vende që nuk kanë TVSH për media. E edhe ato që kanë, sipas saj, nuk e kalojnë vlerën mbi 5% të tatimit. Lama ka uruar që pretimi i Thaçit të bëhet realitet e të mos ndodhë sikur me premtimin që ka bërë për emërimin e zëdhënësit të Qeverisë.



Projektligji pritet të bëhet objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese

Mirëpo, me gjithë fjalimet e shpeshta, ai nuk ka arritur t'i bindë së paku dy deputetët e partisë së tij, Hydajet Hysenin dhe Nait Hasanin, që të rezonojnë ndryshe rreth projektligjit. Hyseni ka thënë se askush nuk është kundër nxjerrjes së një ligji për Qendrën Historike të Prizrenit, por jo edhe të një ligji çfarë u është ofruar deputetëve për ta votuar. Ai ka përfshatuar mundësinë që Pakoja e Ahtisaarit kërkon ligj të veçantë për Prizrenin, duke rikujtuar njëkohësisht se obligim kushtetues i Kuvendit është që ta respektojë vullnetin e qytetarëve. Ndërkaq, deputeti Hasani nuk është pajtuar që projektligji ta definojë Kishën Ortodokse si kishë serbe, duke thënë se ajo kishë duhet të konsiderohet si Kishë Ortodokse e Kosovës, ashtu siç duhet të konsiderohen edhe Kisha Katolike dhe Bashkësia Islame.

Hasani e ka parë të arsyeshme që të organizohet një referendum për punën e këtij projektligji dhe në bazë të rezultatit që del nga ai referendum, më pas të vendoset për hapat që duhet ndërmarrë.

Prizreni si “Jerusalem i modelit grek”

Ish-kryetari i Komunës së Prizrenit, Eqrem Kryeziu, ka ironizuar kryeministrin Thaçi për epitetin që ia kishte dhënë Prizrenit gjatë fushatës zgjedhore. “Kryeministri Thaçi e pati cilësuar Prizrenin si Jerusalem e PDK-së, dhe këtu nuk ka asgjë të keqe. Por me këtë projektligj po druaj se Prizreni po bëhet një Jerusalem i modelit grek. E kjo për rrethanat çfarë është shteti grek sot, nuk i bën shumë nder kësaj qeverie”, ka thënë Kryeziu.

Kundër projektligjit, në emër të gru-

peve parlamentare të LDK-së dhe AAK-së janë shprehur Salih Morina dhe Ardian Gjini. Ky i fundit ka thënë se AAK-ja nuk e ka për obligim që t'ia çojë përpara projektet Qeverisë, për të cilat nuk votojnë as deputetët e koalicionit qeverisës.

Kritikat më të mëdha janë bërë nga deputeti i VV-së, Liburn Aliu, gjë që kanë nxitur edhe replikimin e shpeshtë të kryeministrit Thaçi.

“Ky projektligj është në kundërshtim me të drejtat e njeriut. Ju them që ky është në kundërshtim edhe me vlerat dhe ligjet e vendeve prej nga ata vijnë, dhe nuk kanë të drejtë të na imponojnë neve. Urdhëroni bënì në vendet tuaja, por jo të na impononi neve”, ka deklaruar Aliu.

Projektligji për QHP-në ditëve të fundit ka nxitur edhe reagimin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Ky këshill ia ka tërhequr vërejtjen shefit të ICO-së, Pieter Feith, se po e shkel Pakon e Ahtisaarit, jo vetëm me Projektligjin e Qendrës Historike të Prizrenit, por edhe më atë për Hoqën e Madhe.

“Sipas analizave të hollësishme, dy projektligjet kontestuese në shqyrtim dhe ligji bazë i tyre (Ligji për zona të veçanta të mbrojtura, (Nr. 03-039),) nuk derivojnë nga Pakoja e Statusit të Kosovës. Ato janë produkt i ndryshimeve të parametrave të përcaktuar nga Pakoja dhe u bënë në mënyrë arbitrare nga bartësi dhe grupet punuese që përgatitën ligjet”, thuhet në një nga vërejtjet që i ka bërë ky këshill.

Pro miratimit kanë qenë Grupi parlamentar i PDK-së, ai i KKR-së dhe SLS-së. Rrjedhimisht, me 56 vota për, 42 kundër dhe 2 abstenime, deputetët e kanë miratuar në parim këtë projektligj, duke e bërë pjesë të shqyrtimit brendaparlamentar.

Përdorimi i drogave në shkolla, në rritje

Deputeti i AAK-së, Burim Ramadani, ka alarmuar Kuvendin e Kosovës për nivelin e lartë të përdorimit të drogave nga nxënësit e shkollave të mesme. Duke u bazuar në disa statistika që kishte arritur t'i siguronte, ai ka bërë të ditur se aktualisht mbi 20% e nxënësve të këtij niveli janë përdorues të një lloji të drogës. “Kjo i bie që çdo i pesti nxënës është përdorues i një droge, dhe kjo shifër është shumë shqetësuese”, ka thënë Ramadani. Shqetësuese, sipas tij, është edhe ulja e nivelit të moshës së përdoruesve të drogave. “Të dhënat e fundit flasin se përdorues të drogave janë fëmijët e moshës 12-vjeçare”, është shprehur Ramadani. Nisur nga kjo, në emër të partisë ai ka propozuar ngritjen e një komisioni shtetëror, i cili do të kryesohej nga vetë kryeministri për ta luftuar këtë fenomen. Veç kësaj, ai ka sugjeruar që të bëhet trajnimi i mësimit-hënësve rreth efekteve që shkaktohen nga përdorimi i drogave, si dhe nga janari i vitit të ardhshëm të fillojë draftimi i një strategjie të re kombëtare kundër përdorimit të drogave. Vetëm këtë vit, sipas Ramadanit, kanë vdekur 14 persona nga përdorimi i drogave, ndërsa rreth shkollave ende vazhdon të shitet marihuana. Kuvendi në vazhdim ka miratuar në parim edhe Projektligjin për bujqësi organike, atë për arkivat, Projektligjin për parkun kombëtar “Sharti”, si dhe atë për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

ANALISTI GJERMAN, BODO WEBER, FLET PËR VIZITËN E

KANCELARES MERKEL NË KOSOVË

Lidershipi konsekuent gjerman i BE-së

Kancelarja gjermane me vizitën e saj në Prishtinë i ka mbetur konsekuente linjës politike që ishte definuar në vizitën e saj në Beograd, në gusht të këtij viti, thotë Bodo Weber, analist i njohur gjerman i njohur si ekspert për Ballkanin.

Në një deklaram për “Kohën Ditore”, Weber, analist pranë Këshillit për Politikë të Demokratizimit, tha se “Gjermania befasisht ka hyrë në pozicionin e liderit brenda Bashkimit Evropian me një koncept të qartë politik”.

“Anash faktit që Berlino nuk është nisur me iniciativë të vetën, por vetëm si reagim ndaj dinamikës së dhunshme në veri të Kosovës, sikur që ka reaguar shtatorin e kaluar ndaj kërcënimit të prishjes së marrëdhënieve mes Serbisë dhe Perëndimit pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Anash edhe faktin se do të kishte qenë më mirë që Berlino të kishte vendosur para dy vitesh ta bëjë këtë ndërrim politike, sepse Qeverisë së Tadiqit do t'i kishte lënë kohë të mjaftueshme që të përgatiste ndryshimin e politikës, në vend se tani, gjysmë viti para zgjedhjeve për Parlamentin e Serbisë. Me rëndësi është se dikush më në fund e ka marrë lidërshpin brenda Bashkimit Evropian dhe e ka shtyrë unionin e ndarë në një rrugë që në afat të mesëm do ta zgjidhë përgjithmonë konfliktin rreth Kosovës, dhe Serbinë do ta detyrojë që shtetin e vet ta definojë në baza reale, dhe me këtë asaj t'i sigurojë rrugën në transformimin e përherëshëm demokratik dhe (ri)integrimin evropian”, thotë Weber.

Sipas tij, prej të gjitha shteteve të BE-së, Gjermania është “më së miri e pajisur që ta luaj këtë rol, pikërisht për shkak të fiksimit të saj të më-



Weber: Gjermania është më së miri e pajisur që ta luajë rolin e liderit evropian në Ballkan

parshëm jokritik të politikës së saj në Ballkanin Perëndimor ndaj Serbisë, e cila burimin e ka në luftën e Kosovës dhe në 5 tetorin e vitit 2000, dhe për shkak se në vitin 2007 ka nisur të përkrahë pavarësinë e Kosovës, jo nga dashuria, por për shkak të njohjes së pashmangshmërisë politike”, tha Weber për “Kohën Ditore”.

“Merkel edhe i ka mbetur konsekuente linjës së re politike ashtu që, përkundër rrezikut të madh politik që ka marrë mbi vete, pasi është nisur në konflikt me Beogradin, përkundër rezistencës së qeverive të shumta evropiane, nuk ka harruar që bashkëbiseduesve të vet në Prishtinë t'ua bëjë me dije se është e vetëdijshme për mungesën e sistemit politik dhe elitave politike në Kosovë”, përfundoi Weber.

AMBASADORI GJERMAN NË PRISHTINË FLET PËR

VIZITËN E KANCELARES

Merkel, vizitë kushtuar ushtarëve dhe mirënjohje për pragmatizmin e Prishtinës

PRISHTINË, 20 DHJETOR – Qëndrimi që kancelarja gjermane, Angela Merkel, i bëri Kosovës, të hënën, ka qenë vizitë kushtuar ushtarëve gjermanë të KFOR-it, ndërsa ishte edhe shprehje e mirënjohjes së Berlinit zyrtar për qëndrimet pragmatike të Kosovës në dialog me Beogradin. Kështu ka deklaruar ambasadori i Gjermanisë në Prishtinë, Ernst Reichel, përmes një deklaratë për media të lëshuar nga Ambasada, të martën.

“Vizita e kancelares federale, Merkel, në Kosovë, u kushtojë ushtarëve gjermanë të KFOR-it, të cilët bashkërisht me ushtarët nga vendet tjera rrezikojnë jetën dhe shëndetin e tyre për të kontribuar në normalizimin e gjendjes në veri të Kosovës. Këto femra dhe meshkuj e kanë merituar respektin tonë”, thuhet në deklaratë. “Vizita shpreh edhe mirënjohjen tonë për qëndrimin e përgjegjshëm dhe pragmatik të Kosovës në dialog me Beogradin. Ky dialog është rruga për normalizimin e marrëdhënieve me Beogradin dhe gjithashtu për normalizimin e qëndrueshëm të gjendjes në veri. Gjermania e dëshiron këtë normalizim, ashtu siç e dëshirojnë atë edhe njerëzit në Kosovë. Ky normalizim është një

hap i rëndësishëm i Kosovës, dhe i Serbisë, për integrimin evropian.”

Njëkohësisht, ambasadori Reichel është prononcuar edhe në lidhje me rezolutën për reciprocitet ndaj Serbisë, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, ditë më parë, duke e quajtur atë të padobishme.

“Kjo rezolutë, menjëherë para vendimit të Këshillit Evropian për statusin e kandidatit të BE-së për Serbinë, në asnjë mënyrë nuk ishte e dobishme. Veç kësaj ende mbetet e pasqaruar, se çfarë kërkohet konkretisht me emërtimin ,reciprocitet”, thuhet në deklaratën e ambasadorit Reichel.

“Falë një marrëveshjeje nga dialogu i udhëhequr nga BE, kufijtë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë të hapur për mallra në të dy drejtimet, kështu që reciprociteti tanimë ekziston. Tani ka kërcënime edhe me bllokada në vendkalimet kufitare Merdar dhe Dheu i Bardhë, nëse ky reciprocitet i padefinuar, dhe në të vërtetë ekzistues, nuk realizohet. Gjëja e fundit që i nevojitet këtij vendi janë barrkada tjera dhe më shumë dhunë në kufijtë me Serbinë. Kushdo që e ndjek këtë rrugë, nuk i kryen shërbim vendit të tij”, përfundon deklaratë e ambasadorit gjerman.